


# INTERVENIMI PËR QASSHMERI TË PERSONAVE ME AFTESI TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET SHKOLLORE - RASTI I SH.F.M.U "FADIL HISARI"



## INTERVENIMI PËR QASSHMERI TË PERSONAVE ME AFTESI TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET SHKOLLORE - RASTI I SH.F.M.U "FADIL HISARI"

Ky vizionim është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "HumanRightivism" që implementohet nga Community Development Fund–CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve.



# HYRJE

Personat me Aftësi të Kufizuar në Kosovë në përgjithësi përballen me diskriminim shumëdimensional në baza ditore. Sfidat për qasje në objekte të ndryshme, në transport publik, shëndetësi, arsim e punësim për këtë komunitet paraqesin pengesë në drejtim të gëzimit të drejtave të garantuara kushtetuese e ligjore, gjë që bën që PAK të mos gëzojnë as mundësi të barabarta si pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. <sup>1</sup>

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar që është miratuar bashkë me Protokollin Opsional në dhjetor të vitit 2006 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara paraqet përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare për përfshirjen e perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar në të gjithë aspektet e shoqërisë dhe të zhvillimit. Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. <sup>2</sup>

Edhe Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 që paraqet një dokument të rëndësishëm dhe që ka për mision krijimin e politikave më të qëndrueshme në fushën e të drejtave të PAK, liston edhe krijimin e kushteve të barabarta në qasje, informim dhe komunikim për Personat me Aftësi të Kufizuara. Për të qenë i realizueshëm ky objektivi që PAK të jetojnë në mënyrë të pavarur, shteti duhet të merr masat e duhura për të siguruar qasje në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit. <sup>3</sup>

Në Kosovë, po ashtu edhe Ligji për Arsimin Parauniversitar, në disa nene e rregullon ofrimin e shkollimit për të gjithë. Neni 3 me dispozitat e veta siguron që asnjë fëmije nuk do t'i mohohet e drejta për shkollim. Në këtë drejtim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT) dhe komunat e kanë për detyrë krijimin e të gjitha kushteve për ta vënë në zbatim këtë parim të këtij ligji. Neni 39 dhe 40 në veçanti merren me përkufizimet themelore dhe kriteret për akomodimin e gjithë fëmijëve në institucionet arsimore pavarësisht aftësive fizike, intelektuale, sociale, etj. Po ashtu, ky ligj përcakton që komunat duhet të përshtatin ndërtesat shkollore për të komoduuar fëmijët me aftësi të kufizuara.<sup>4</sup>

# Përmbajtja

<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT.....</b>	<b>6</b>
-SITUACIONI.....	7
-BAZA E RAMPËS.....	8
-PRERJET E RAMPËS.....	9
-DUKJET E RAMPËS.....	10
-VIZUALIZIMET.....	11
<b>REFERENCAT.....</b>	<b>13</b>
<b>PËR EC.....</b>	<b>14</b>

## PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT - INTEVENIMIT : RAMPA NË SH.F.M.U. "FADIL HISARI"

Duke synuar shmangien e barrierave të cilat pamundësojnë lëvizjen dhe qasjen e PAK në hapësirën e shkollës "Fadil Hisari", EC ka realizuar një vizionim të rampës sipas parimeve, normave dhe standardeve të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar i cili përcakton në mënyrë të detajuar trajtimin e elementeve të ndryshme të hapësirave publike dhe objekteve në mënyrë që ato të ofrojnë qasje të barabartë për të gjithë.

Raporti i vizionimit për rampën në shkollën "Fadil Hisari" ofron një pasqyrë rreth procesit të përpilimit të konceptit zhvillimor përmes procesit me pjesëmarrje aktive të publikut dhe projektin ideor për ndërtimin e rampës.


Ndërtimi i kësaj rampe do t'iu ofrojë lëvizje më të lehtë dhe më të sigurtë Personave me Aftësi të Kufizuara duke minimizuar rrezikun e aksidenteve dhe lëndimeve. <sup>5</sup>

# SITUACIONI

S+P+1




# BAZA E RAMPËS






# PRERJET E RAMPËS





## Prerja A



## Prerja B



# DUKJET E RAMPËS







# REFERENCAT

- <sup>1</sup> [https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/170125101233\\_Analiza\\_PAK\\_final\\_WEB.pdf](https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/170125101233_Analiza_PAK_final_WEB.pdf)
- <sup>2</sup> [https://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd\\_albanian.pdf](https://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf)
- <sup>3</sup> [Qeveria e Kosovës, Strategjia Nacionale për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023](#)
- <sup>4</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- <sup>5</sup> <https://penn-yorkmedical.com/2021/03/the-advantages-of-wheelchair-ramps/>

# PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm.

Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e komprometuar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë: 1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion; 2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës; 3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe 4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.